

MARRËVESHJE PËR SHITBLERJEN E KUOTËS

Sot, në datë 20 10/2023, në Tiranë, nënshkruhet kjo Marrëveshje për Shitblerjen e Kuotës ("Marrëveshja") midis palëve, si më poshtë:

PALA SHITËSE: **Merita Gurabardhi**, shtetase shqiptare, lindur në më 24/06/1974, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal H45624130C, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim referuar si "**Shitësja**")

PALA BLERËSE: **Ervin Xhomo**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, 25/05/1974, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H40525244Q, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim referuar si "**Blerësi**")

Shitësja dhe Blerësi, të cilët referohen "bashkërisht si "**Palët**" dhe individualisht si **Pala**".

MEQËNËSE

- I. Shitësja është Ortake e Vetme e "**EB ENERGY**" SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me Numër Unik Identifikimi Subjekti (NUIS): M02223031F, me seli në adresën: Rruga "Marko Boçari", Pallati "Sara EL", Kati 1, Apt. 3, Tiranë, Shqipëri (në vijim referuar si "**Shoqëria**");
- II. Shitësja është mbajtëse e 1 (një) kuote të barabartë me 100,000 (njëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë (në vijim referuar si "**Kuota**");
- III. Blerësi mban pozicionin e administratorit të Shoqërisë për një mandat emërimi deri në datën 23/03/2028;
- IV. Shitësja dhe Blerësi kanë cilësinë e bashkëshortëve dhe, brenda kufijve të marrëdhënies së tyre martesore, mbajnë një regjim të ndarë të pasurisë. Ekzistenca e këtij regjimi funksionon në mënyrë të pavarur nga prerogativa e Shitëses për të shitur Kuotën dhe nga synimi i Blerësit për ta blerë atë;
- V. Në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje, Shitësja dhe Blerësi kanë rënë dakord për transferimin e Kuotës.

PËR SA MË SIPËR, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe duke marrë në konsideratë miratimet reciproke të shprehura këtu, Palët bien dakord si më poshtë:



NENI 1

OBJEKTI

Objekti i kësaj Marrëveshje është të transferojë me efekt të menjëhershëm, titullin ligjor mbi Kuotën, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, nga Shitësja tek Blerësi.

NENI 2

ÇMIMI I BLERJES

2.1 Palët bien dakord që çmimi i pagueshëm nga Blerësi për blerjen e Kuotës në përputhje me këtë Marrëveshje, do të jetë në vlerën nominale të saj, 100,000 (*njëqind mijë*) Lekë (në vijim referuar si “**Çmimi i Blerjes**”), i cili do të paguhet nga Blerësi në llogarinë bankare të Shitëses brenda 5 (*pesë*) ditëve punë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

NENI 3

TRANSFERIMI I TITULLIT TË KUOTËS

3.1 Titulli i Kuotës i transferohet Blerësit menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje dhe Blerësi bëhet zotëruesi dhe pronari i vetëm ligjor i saj.

3.2 Transferimi i titullit të Kuotës nuk kushtëzohet nga shprehja e vullnetit me formë noteriale, në përputhje edhe me nenin 73/2 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, apo nga regjistrimi i saj, i cili do të ketë efekt deklarativ.

NENI 4

DEKLARIME DHE GARANCI

4.1 Shitësja deklaron dhe garanton Blerësin si vijon:

- a. Shitësja është zotëruese e ligjshme e 1 (një) Kuote të Shoqërisë dhe Kuota është e shlyer tërësisht;
- b. Shitësja zotëron Kuotën të lirë nga çdo peng, barrë siguroese, hipotekë, kufizime, apo masë tjetër sigurie apo ligjore, si dhe nuk ekzistojnë pretendime nga ndonjë palë e tretë mbi të drejtat e pronësisë së Kuotës, të tashme apo potenciale, e cila mund të ketë një impakt material mbi të drejtën e pronësisë në të ardhmen.

4.2 Secila prej Palëve kontraktore garanton se, përmbush kushtet ligjore të nënshkruajë këtë Marrëveshje dhe të gjitha kushtet dhe afatet e parashikuara këtu janë të detyrueshme për t’u zbatuar prej tyre.

4.3 Shitësja me kostot e saj, do të mundësojë dorëzimin e të gjithë dokumentacionit tek Blerësi për t’i dhënë Marrëveshjes.

4.4 Blerësi në cilësinë e administratorit aktual të Shoqërisë, ngarkohet me regjistrimin e kësaj Marrëveshje në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit duke aksesuar llogarinë e biznesit të Shoqërisë nëpërmjet portalit qeveritar *e-albania*, si dhe kryen çdo regjistrim tjetër të nevojshëm pranë çdo autoriteti kompetent të përcaktuar me ligj.

NENI 5

TAKSAT E APLIKUESHME

5.1 Të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e një natyre tjetër, të tashme dhe/ose të mëvonshme në lidhje me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj Marrëveshje do të paguhet sipas ligjit.

NENI 6

LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

6.1 Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim ose pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ose shkelja, përfundimi ose pavlefshmëria e saj, që nuk mund të zgjidhet përmes diskutimeve miqësore, do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 7

TË NDRYSHME

7.1 Mos ekzekutimi nga ndonjëra prej palëve të ndonjë të drejte nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë. Në asnjë rast veprimet ose mosveprimet e ndonjërës prej palëve, me përjashtim të rastit kur pala heq dorë në mënyrë të shprehur me shkrim, nuk do të përbëjnë heqje dorë nga kjo palë nga të drejtat e lindura nga shkelja e Marrëveshjes në tërësi apo të ndonjë dispozite të saj në veçanti. Nëse ndonjë palë heq dorë nga të drejtat e lindura nga shkelja e ndonjë dispozite të Marrëveshjes nga ana e palës tjetër, në një apo më shumë raste, nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga të drejtat e saj në rast të shkeljes së mëpasshme të po së njëjtës dispozite, apo si heqje dorë nga zbatimi i dispozitës së shkelur.

7.2 Kjo Marrëveshje zëvendëson të gjitha komunikimet dhe negociatat e mëparshme, në formë të shkruar dhe verbale, midis palëve nënshkruese. Nuk ka deklaram, premtim, deklaratë ose qëllim në formë të shkruar ose verbale, midis palëve që nuk është përfshirë këtu dhe që mund të kenë pasojë ose efekt mbi Marrëveshjen ose objektin e saj.

7.3 Kjo Marrëveshje nuk do të ndryshohet, zëvendësohet ose anulohet përveç se me një dokument në formë shkresore të nënshkruar nga të dyja palët dhe çdo dokument që ka për qëllim të ndryshojë, zëvendësojë ose anulojë atë ose pjesë të saj nuk do të jetë i detyrueshëm dhe nuk do të ketë efekt deri në momentin që nënshkruhet dhe dorëzohet nga të dyja palët.

7.4 Nëse ndonjë nga nenet e Marrëveshjes shpallet e pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria ose zbatueshmëria e neneve të tjera nuk do të ndikohet. Neni i pavlefshëm do të zëvendësohet nga një i vlefshëm i cili korrespondon sa më shumë të jetë e mundur qëllimit të palëve.

7.5 Në këtë Marrëveshje, përveç se kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët në njëjës do të përfshijnë edhe fjalët në shumës dhe e anasjelltas, fjalët që përfaqësojnë një gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër. Gjuha në të gjitha rastet do të interpretohet si një e tërë në përputhje me kuptimin e saj të drejtë dhe pa nënkuptuar

supozime se kushtet në të duhet të interpretohen më rreptësisht kundër njërës Palë; bëhet me dije se të dyja Palët kanë marrë pjesë në hartimin dhe negocimin e kësaj Marrëveshje.

7.6 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja hartohet në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Palët e lexuan atë dhe deklarojnë se është konform vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar, në shenjë pranimi e nënshkruajnë atë.

PALËT NË KONTRATË

SHITËSJA

ZNJ. MERITA GURABARDHI



BLERËSI

Z. ERVIN XHOMO

